

# fakte

## Dhuna kolektive

Dhuna kolektive merrë një nivel të lartë të vëmendjes publike. Konfliktet e dhunshme ndërmjet popujve dhe grupeve, shtetit dhe terorizmit grupor, përdhunimeve si armë luftarake, lëvizja e numrit të madhë të njerëzve të zhvendosur nga shtëpitë e tyre dhe ballafaqimet e bandeve ... e gjithë kjo ndodhë çdo ditë në pjesë të ndryshme të botës. Efektet e ngjarjeve të këtu mbi shëndetin, në kuptimin e vdekjes, sëmundjeve fizike, invaliditetit dhe joqetësisë mentale janë të mëdha.

Dhuna kolektive mund të definohet si: përdorim i dhunës si instrument nga njerëz të cilët veten e identifikojnë si pjesëtar të grupeve, pa marrë parasysh nëse grupi është tranzitor apo identiteti i përhershëm, kundërt një grupi tjetër ose kolektivë individësh, për arritjen e qëllimeve politike, ekonomike apo sociale.

### SHKALLA E PROBLEMIT

- Shekulli 20 ishte njëra nga periudhat më të dhunshme në historinë e njerëzimit. Vlerësohet se rreth 191 milion njerëz kanë humbur jetën në mënyrë direkt apo indirekte si pasojë e konfliktit, dhe më shumë se gjysma e tyre ishin civil.
- Në vitin 2000 më shumë se 300 000 persona vdiqën si rezultat direkt i konflikteve me dhunë. Shkalla lëvizte nga më pak se 1 në 100 000 banor në vendet e pasura, deri në 6,2 në 100 000 në vendet e varfëra dhe vendet mesatarisht të zhvilluara.
- Në botë, shkallë më të lartë të vdekshmërisë si rezultat i konfliktit janë të vërtetuar në Afrikë (32,0 në 100 000).
- Përveç mijëra viktimave në konflikte me dhunë çdo vitë, ka një numër shumë të lartë të personave me lëndime fizike, duke e përfshirë këtu ata me hendikep të përhershëm apo të sakatosur.
- Tortura dhe përdhunimi gjithashtu përdoren për terorizim dhe varrosjen e bashkësive, edhe pse është e vështirë të vërtetohet numri i saktë i personave të cilët i janë nënshtruar keqpërdorimit të tillë. Shumë njerëz i fshehin traumat që i kanë përjetuar, kurse palët në konflikt shumë shpesh mundohen që ti manipulojnë ose ti fshehin dëshmit për torturat dhe përdhunimet.

### PASOJAT E DHUNËS KOLEKTIVE

Pasojat nga konfliktet e dhunshme ndaj shëndetit mund të jenë shumë të mëdha në kuptimin e vdekshmërisë, morbiditetit (lëndueshmërisë) apo invaliditetit.

Shkallët e rritura të vdekshmërisë së civilëve gjatë kohës së konflikteve me dhunë, zakonisht janë si rrjedhojë e:

- lëndimeve,
- qasjes të zvogëluar për ushqim, gjë që sjell deri tek ushqyerja e pakët,
- rrezik i zmadhuar nga sëmundjet bartëse,
- qasje të zvogëluar të shërbimeve shëndetësore,
- programe të zvogëluara për shëndetësi publike,
- kushte të vështira në mjedis,
- shqetësimet psikologjike.

Fëmijët dhe refugjatët hyjnë në grupin më të ndijshëm ndaj sëmundjeve dhe vdekjes gjatë kohës së konfliktit. Rritja e shkallës së morbiditetit dhe vdekshmërisë të këtyre dy grupeve mund të jetë dramatike.

Dhuna dhe vrazhdësia lidhen me një rrjedhojë të gjerë të problemeve psikologjike dhe të sjelljes duke përfshirë depresionin, ankiozitetin, sjelljen vetëvrasëse, keqpërdorimin e alkoolit dhe çrregullimet post traumatike stresore.

Konfliktet i pengojnë aktivitetet tregtare dhe aktivitete tjera zyrtare me ridistribucionin e resurseve prej shërbimeve tjera vitale në atë të mbrojtjes. Ato ndikojnë në prodhimtarinë dhe distribuimin e ushqimit dhe shpërngulin mijëra persona nga shtëpitë e tyre. Vlerësohet se uria në luftë, konfliktet tjera të armatosura apo gjenocidet, kanë vrarë 40 milion persona në shekullin 20.



Organizata  
botërore  
e shëndetësisë



Ministria e  
shëndetësisë, RM



Enti Republikan  
për mbrojtje  
shëndetësore



Fondacioni Instituti i  
Hapur i Shoqërisë Civile  
në Maqedoni



Shoqata për emancipim,  
solidaritë dhe barazi  
gjinore në RM



## SHEMBUJ TË NDIKIMT DIREKT TË DHUNËS KOLEKTIVE MBI SHËNDETIN

Ndikim mbi shëndetin	Arsyet
Vdekshmëria e rritur	<ul style="list-style-type: none"><li>• Vdekje përshkak arsyeve të jashtme, kryesisht të lidhura me armë</li><li>• Vdekje përshkak të sëmundjeve ngjitëse (fruthit, poliomyelitis, tetanusit apo malarisë)</li><li>• Vdekje përshkak të sëmundjeve jo bartëse, si dhe sëmundjeve të tilla që mund të shmangen me mbrojtje mjekësore (përfshirë asmën, diabetin dhe kirurgjin urgjente)</li></ul>
Morbiditeti i rritur	<ul style="list-style-type: none"><li>• Lëndime nga arsye të jashtme, si prej armëve, sakatosja, mina, djegëje dhe helmime</li><li>• Morbiditeti i lidhur me arsye të tjera të jashtme, përfshirë këtu edhe dhunën seksuale</li><li>• Sëmundjet ngjitëse<ul style="list-style-type: none"><li>- Nëpërmejt ujit (si kolera, tifoja, dezinterija, sëmundjet e barkut)</li><li>- Nëpërmjet insekteve (si malarja)</li><li>- Sëmundje tjera bartëse (si tuberkulozi, infeksioneve akute të frymëmarrjes, HIV dhe sëmundjeve tjera seksuale bartëse)</li></ul></li><li>• Shëndet reproduktiv:<ul style="list-style-type: none"><li>- Numër më i madhë i foshnjëve të vdekura i lindjeve të parakohshme, më shumë raste të peshës së ulët në lindje si komplikime më të shumta gjatë lindjes.</li><li>- Ndikim afatgjatë gjenerik nga efektet e kemikalieve dhe radiacionit.</li></ul></li><li>• Të ushqyerit:<ul style="list-style-type: none"><li>- të ushqyerit e pakët akut dhe kronik si dhe çrregullime të ndryshme</li></ul></li><li>• Shëndet mental:<ul style="list-style-type: none"><li>- anksozitet</li><li>- depresioni</li><li>- çrregullim post-traumatik stresor</li><li>- sjellje vetëvrasëse</li></ul></li></ul>
Invaliditeti i rritur	<ul style="list-style-type: none"><li>• Fizik</li><li>• Psikologjik</li><li>• Social</li></ul>

## CILËT JANË FAKTORËT-RREZIK TË DHUNËS KOLEKTIVE?

Rrënjët e konflikteve të dhunshme zakonisht janë të thella dhe mund të jenë rezultat i tensioneve afatgjate ndërmjet grupeve. Egzistojnë faktor të numërt të cilat shtetet i vejnë në rrezik të konflikteve të dhunshme. Të tilla janë:

- Mungesa e proceseve demokratike dhe qasje jo e barabartë ndaj fuqisë. Rreziku është veqanërisht i lartë kur fuqia del nga identitetet etnike apo religjioze dhe kur udhëheqësia është represive dhe e disponuar për keqpërdorim të të drejtave të njeriut.
- Ndryshimet sociale të përcjellura me shpërndarjen dhe qasje shumë të lartë pabarazie ndaj resurseve. Konflikti është shumë i mundshëm kur ekonomia është në rrënie, duke e keqësuar pabarazin sociale dhe intensifikimin e garës për resurse.

- Kontrolli nga njëri grupë ndaj resurseve natyrore të vlefshme, si diamanti, nafta, druri dhe barnat.
- Ndryshime rapide demografike që e zvoglojnë kapacitetin e shtetit për sigurimin e shërbimeve themelore dhe mundësis për punësim.

Para se të ndodh dhuna kolektive e hapur, mund të përcaktohen shumë nga këto faktor-rreziku.

## ÇKA MUND TË BËHET QË TË PARANDALOHET DHUNA KOLEKTIVE?

Egzistojnë masa të shumta për parandalimin e dhunës kolektive, kurse atje ku ajo do të shfaqet për uljen e ndikimit të tij.

Disa prej politikave të përgjithshme që janë të domosdoshme për uljen e potencialit të konflikteve të dhunshme, janë:

- Ulja e varfërisë edhe në terme absolute edhe ato relative; garancë që ndihma në zhvillim është e drejtuar në mënyrë të tillë që të ketë ndikimin më të madhë ndaj varfërisë.
- Uljen e pabarazisë ndërmjet grupeve në shoqëri
- Uljen e qasjes tek armët biologjike, kimike, nukleare dhe armë tjera.
- Garantimi i promovimit dhe përdorimit të kontratave ndërkombëtare, duke i përfshirë dhe ato për të drejtat e njeriut.

Qeveritë nacionale mund të ndihmojnë në preventimin e konflikteve nëpërmjet mirëmbajtjes të shpirtit të kapitullit të OKB, e cila thëret në ndalimin e agresionit dhe përparimit të paqes dhe sigurisë. Më detalisht, kjo do të thotë përmbytje tek instrumentet juridike ndërkombëtare, ku hyjnë Konventa e Zhenevës prej vitit 1949 dhe protokolet e tyre nga viti 1977.

Investimi në zhvillimin e shëndetsisë mund të ndikojë në preventimin e konflikteve të dhunshme. Akcenti i fortë në shërbimet sociale mund të ndihmon që të mbahet kohezioni dhe stabiliteti shoqëror.

Shpesh herë, manifestime të gjendjeve të hershme të cilat mund të sjellin deri tek konfliktet e dhunshme, që mund të zbulohen në sektorin e shëndetësisë. Punëtorët shëndetësor kanë një rol të veçantë në tërheqjen e vëmendjes ndaj këtyre shenjave dhe në ngritjen dhe alarmimin për intervenime adekuate sociale dhe shëndetsore.